

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6830
E martë, 21 shkurt 2023
çmimi 0.40 €

Mbi 12 milionë euro dëme nga vërshimet në Skenderaj



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

PRESIDENTI I SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS, JOE BIDEN,
KA QËNDRUAR TË HËNËN NË KIEV, NË NJË VIZITË TË PAPANALAJMËRUAR

BIDENI NGA KIEVI: LUFTA E PUTINIT PO DËSHTON



Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Joe Biden, ka qëndruar të hënën në Kiev, në një vizitë të paparalajmëruar, të parën prej se Rusia nisi pushtimin e këtij vendi gati një vit më parë. Ai është takuar me presidentin

ukrainas Volodymyr Zelensky, të cilit i ka rikonfirmuar angazhimin e palëkundur të ShBA-së ndaj demokracisë, sovranitetit dhe tërësisë territoriale të Ukrainës. "Ukraina qëndron në këmbë. Demokracia qëndron. Amerikanët qëndrojnë

me ju dhe bota qëndron me ju", ka thënë Bideni, duke paralajmëruar se ShBA-ja po përgatit një dërgesë të re të "pajisjeve kritike" për Ukrainën, e cila do të përfshijë municione artilerie dhe radarë të mbikëqyrjes ajrore

OPINION

A JANË
KRIMINELËT DHE
TRADHTARËT NË
BURGUN E HAGËS
APO NË DISA KOKA
TË KRISURA
NË KOSOVË?!



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

AKTUALE



AVOKATI I FAMILJES DEHARI
KËRKON T'I LEJOHET PJESËMARRJA
NË INTERVISTIMIN E ABAZIT

SHOQPËRIA BLOKON
ANIJEN ME 22 500 TONË NAFTË
KONTRABANDË NGA RUSIA

EKONOMI



MËRGATA VAZHDON REKORDIN E
REMITENCEVE, GJATË 2022-S SOLLI
MBI 1.2 MILIARD EURO NË KOSOVË

BANGLADESHI PO E SHEH KOSOVËN
SI POTENCIAL BASHKËPUNIMI PËR TA
ZGJERUAR EKONOMINË DIGJITALE

SPORT

LIGA KAMPIONËVE SJELL
PËRBALLJEN LIVERPOOL - REAL

QË NGA
SHPALLJA E
PAVARËSISË
KOSOVËN
E KANË
BRAKTISUR
RRETH 375
MIJË PERSONA



GRUDA:
PROKURORIA
T'I
INTERVISTOJË
KURTIN
DHE HAXHIUN
PËR RASTIN
'DEHARI'



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Policia bullgare ndalon një minibus me 43 emigrantë

SOFIJE, 20 SHKURT - Policia bullgare ka ndaluar të dielën një minibus me 43 emigrantë pranë qytetit Ikhiman, sipas agjencisë së lajmeve BTA. Më vonë, të hënën në mëngjes, prokurorja e distriktit të Sofjes, Natalia Nikolova, tha për bTV se dhjetë nga emigrantët ishin fëmijë. Lajmi vjen pasi 18 emigrantë u gjetën të mbytur në një kamion të braktisur pranë fshatit Lokorsko të Sofjes të premtën. 34 persona të tjerë u gjetën në gjendje të rëndë. Sipas Nikolovës, minibusi i sekuestruar të dielën u pajis me karburant, por shoferi nuk pagoi. Një makinë patrullimi e kapi dhe policia konstatoi se në furgon kishte emigrantë. Dy nga fëmijët janë të moshës 8 dhe 12 vjeç dhe udhëtonin me babanë e tyre, ndërsa shtatë të mitur të tjerë udhëtonin të vetëm. Të gjithë emigrantët janë në gjendje të mirë shëndetësore, megjithëse kishin qenë duke qëndruar në një hapësirë të vogël.

Pas ngjarjeve të së premtes, shtatë persona janë arrestuar. Të hënën Prokuroria e Sofjes do të kërkojë arrestimin e përhershëm të pesë prej tyre. Ata akuzohen për bashkëpunim në vdekjen e 18 emigrantëve.

Të dielën një tjetër person u ndalua në Greqi si bashkëpunëtor në këtë krim. Autoritetet greke do t'i shqyrtojnë mundësitë se si ta ekstradojnë atë në Bullgari, tha për BTA zëvendësprokurori i Sofjes, Hristo Krastev.

Zëvendësprokurori i përgjithshëm, Borislav Sarafov, njoftoi të premtën se emigrantët kaluan kufirin duke përdorur një shkallë, pastaj kaluan disa ditë në pyll afër qytetit të Yambol dhe më pas u ngarkuan në minibus.

Të gjithë pasagjerët ishin burra të moshës 13 deri në 35 vjeç, shumica e tyre nga Afganistani. Asnjë prej tyre nuk posedonte dokumente identifikimi, ndaj të gjitha informacionet që autoritetet kanë



për ta vijnë nga vetë rrëfimet e 34 të mbijetuarve.

Ata donin të transportoheshin në Serbi, prej nga do të vazhdonin rrugën për në Evropën perëndimore. Hetimi i autoriteteve bullgare zbuloi se emigrantët paguanin nga 5 000 deri në 7 000 euro për transport. Kreu i grupit

merrte nga 500 deri në 1 000 euro për person, ndërsa shoferët 100 euro për emigrant të transportuar. Në vitin 2015, në një rast të ngjashëm, trupat e 71 emigrantëve u gjetën në një kamion të braktisur në Austri. Më pas, katër trafikantë njerëzish u dënuan me burgim të përjetshëm, duke përfshirë një

afgan, udhëheqës i grupit, dhe tre bashkëpunëtorë bullgarë. Ata u shpallën fajtorë për trafikim të organizuar të qenieve njerëzore dhe vrasje. Ata refuzuan ta ndalonin kamionin dhe t'i hapnin dyert për të lejuar qarkullimin e ajrit pavarësisht prej lutjeve të njerëzve të ngjeshur brenda.

BE-ja thërret konferencë donatorësh për Turqinë dhe Sirinë



BRUKSEL, 20 SHKURT - Komisioni Evropian, së bashku me Presidencën Suedeze të Këshillit, do të organizojnë më 16 mars një konferencë të madhe donatorësh në Bruksel, për të mbledhur kontribute për ndihmë për Turqinë dhe Sirinë, në përballje me pasojat e tmerrshme të tërmetit që ka goditur pjesë të këtyre dy vendeve.

Njoftimin për organizimin e kësaj konference e ka konfirmuar të hënën Dana Spinat, zëdhënëse e Komisionit Evropian. Pritet që në këtë konferencë Komisioni Evropian të japë një kontribut të madh shtesë, në të njëjtën kohë priten edhe donacione individuale të vendeve anëtare, të vendeve fqinje, organizatave ndërkombëtare dhe donatorëve privatë.

Bashkimi Evropian edhe deri tash ka ndihmuar Turqinë dhe Sirinë

përmes dërgimit të ekipeve për intervenim të shpejtë, por edhe përmes ndihmës materiale. Por, në BE vlerësojnë se nevojat për rimëkëmbje pas tërmetit, për kujdesin për njerëzit e goditur nga pasojat, do të jenë të mëdha dhe të gjata. Prandaj edhe ka vendosur të thërrasë konferencë donatorësh.

BE-ja kishte organizuar një konferencë donatorësh edhe për ta ndihmuar Shqipërinë pas tërmetit. Në atë konferencë ishin premtuar mbi 1 miliard euro, si në ndihmë të pakthyeshme, ashtu edhe përmes kredive të favorshme. Por, krahasuar me pasojat dhe dëmet e tërmetit në Shqipëri dhe hapësirën që kishte përfshirë, tërmeti i fundit në Turqi dhe Siri është një prej më të mëdhenjve që ka parë Evropa në kohën moderne. Prandaj, në BE presin dhe mobilizim të madh të donatorëve për ndihmë.

BE-ja vendos sanksione të reja për zyrtarë dhe organizata iraniane

BRUKSEL, 20 SHKURT - Bashkimi Evropian vendosi të hënën sanksione ndaj dy organizatave dhe 32 zyrtarëve iranianë, duke përfshirë ministrat e Kulturës dhe të Arsimit, zyrtarët e inteligjencës dhe ligjëbërësit shkak i akuzave për përfshirje në fushatën brutale të Iranit ndaj protestuesve. Protestat filluan pas vdekjes së 22-vjeçares Mahsa Amini më 16 shtator gjatë kohës sa ishte e arrestuar nga policia morale e Republikës Islamike.

Këto protesta janë shndërruar në një nga sfidat më të mëdha për teokracinë e Iranit që nga Revolucioni Islamik i vitit 1979.

Të paktën 529 njerëz janë vrarë në demonstrata, sipas Aktivistëve të të Drejtave të Njeriut në Iran. Mbi 19 700 të tjerë janë arrestuar nga autoritetet si pjesë e fushatës iraniane që ka për qëllim shtypjen e protestave. Disa persona të lidhur me këto protesta janë ekzekutuar.

BE-ja tha se ka vendosur ngrirje të

aseteve dhe ndalime udhëtimi për 32 zyrtarë, si dhe ka ngrirë asetet e dy organizatave për shkak të përfshirjes së tyre "në shkelje të rënda të të drejtave të njeriut në Iran".

Më parë, blloku 27-kombësh kishte vendosur katër runde sanksionesh ndaj zyrtarëve dhe organizatave iraniane duke përfshirë ministrat të tjerë, oficerë ushtarakë dhe policinë morale të Iranit mbi akuzat për abuzim me të drejtat e njeriut.



Që nga shpallja e pavarësisë Kosovën e kanë braktisur rreth 375 mijë persona

PRISHTINË, 20 SHKURT (ER) - Kosova edhe 15 vjet pas pavarësisë ballafaqohet me probleme dhe sfida të shumta të cilave, fatkeqësisht, nuk po u shihet fundi. Sami Behrami, i cili është doktor i Shkencave të Demografisë - Gjeografisë, ka numëruar një sërë aspektesh që kanë nxitur ikjen e të rinjve nga Kosova. “Problemet ekonomike, sociale, politike, arsimore, shëndetësor, juridike, të sigurisë si dhe sjelljet devijonte shoqërore (nepotizmi, korrupsioni, mosrespektimi i meritokracisë si vlerë etj.), kanë shkaktuar humbjen e shpresës të një numër i madhe i popullsisë së Kosovës, sidomos të të rinjtë të cilët nuk shohin perspektivë për jetë në Kosovë”, ka thënë ai. Behrami ka theksuar se humbja e perspektivës është dëmi më i madh që i është shkaktuar

popullatës së Kosovës me efekte negative në të gjitha sferat e jetës, duke mos përjashtuar edhe zhvillimet demografike. “Proceset demografike nuk zhvillohen të izoluara jashtë rrjedhave shoqërore, por në varësi të ndërsjellë edhe të faktorëve biologjikë, ekonomikë, socialë, politikë, historikë, psikologjikë, hapësinorë etj. Si pasojë e zhvillimeve të pafavorshme në të gjitha fushat e lartpërmendura, sot Kosova ndodhet para ndryshimeve radikale në profilin e saj demografik. Këtë më së miri e argumentojnë faktet se: në njërin anë kemi zvogëlim drastik të numrit të lindjeve dhe shtimit natyror, në anën tjetër si pasojë e emigrimeve selektive popullsia po plaket me trendë të përshpejtuara. Situata është aq e pafavorshme

saqë mund të përcaktohet edhe si krizë demografike”, është shprehur ai. Sipas Behramit, në Kosovë në 15 vjetët e pavarësisë kanë lindur rreth 380 mijë foshnje, ndërsa në të njëjtën periudhë kanë vdekur mbi 121 mijë persona, ndërsa shtimi natyror në 15 vjet të pavarësisë ishte 258 mijë persona. Por, po ashtu, siç thekson ai, fatkeqësisht, edhe pse shtimi natyror pozitiv, emigrimet e popullsisë kanë ndikuar që popullsia e Kosovës në këtë periudhë të stagnojë. “Në 15 vjet të pavarësisë Kosovën e kanë braktisur rreth 375 mijë banorë që është i përafërt me numrin e lindjeve, por shumë më i lartë se shtimi natyror. Në Kosovë që nga shpallja e pavarësisë e deri më sot kanë lindur rreth 380 mijë banorë të rinj. Trendët e zvogëlimit të

lindjeve janë shqetësuese. Këtë më së miri e argumenton fakti se përderisa në vitin 2008 Kosova kishte 34 399 lindje, në vitin 2021 numri zvogëlohet në 22 830 lindje. Për përmasat e zvogëlimit të numrit të lindjeve më së miri flet fakti se në Kosovë në vitin 2008 brenda ditës kanë lindur mesatarisht 94 foshnja, ndërsa në vitin 2021 ky numër zvogëlohet në 62 lindje në ditë. Gjatë periudhës së pavarësisë lindshmëria në Kosovë është zvogëluar për - 33.6 për qind, me zvogëlim prej 2.3-përqindësh në vit”, shton ai. Behrami thekson se në të njëjtën periudhë në Kosovë kanë vdekur rreth 122 mijë banorë. “Për dallim nga lindshmëria, numri i rasteve të vdekjeve gjatë kësaj periudhe ka shënuar rritje. Përderisa në vitin 2008 në Kosovë kanë vdekur 6 852 persona, në vitin

2021 kjo shifër gati dyfishohet, arrin në 13 019 persona. Thënë më ndryshe, përderisa në vitin 2008 brenda ditës kanë vdekur mesatarisht rreth 19 persona, në vitin 2021 numri mesatar i të vdekurve brenda ditës arrin në 36”, ka treguar ai. Shtimi natyror i popullsisë në 15 vjet pavarësi në Kosovë ishte 258 mijë banorë, që është dukshëm më i ulët se emigrimet në të njëjtën periudhë. Gjithashtu, trendi i rënies së shtimit natyror është edhe më i shpejtë sesa numri i lindjeve. “Derisa në vitin 2008 popullsia e Kosovës shtohet për 27 547 banorë të rinj në vit, në 2021 shtimi natyror bie në 9 811 banorë. Kështu popullsia e Kosovës në vitin 2008 brenda ditës është rritur për 76 banorë të rinj, ndërsa në vitin 2021 për vetëm 27 banorë”, ka thënë Behrami.



Çitaku: Me liderët e sotëm kanë filluar të mbyllen dyert që Kosova i kishte të hapura

PRISHTINË, 20 SHKURT - Nën kryetarja e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Vlora Çitaku, ka kritikuar presidenten Osmani, kryeministrin Kurti për takimet që kanë zhvilluar së fundi në kuadër të Konferencës në Munihi. “Dikur, në takime të

rëndësishme ku ishte ShBA-ja, Kosova ishte palë, e jo temë. Sot, palë është Serbia e temë Kosova, ndërsa krerët e institucioneve tona sillen korridore për të shtrënguar simbolikisht ndonjë dorë, sikur të ishin turistë të interesuar për fotografi e jo përfaqësues të një

shteti që i duhet përkrahja e ShBA-së”, ka shkruar Çitaku në “Facebook”. Ajo ka theksuar se me liderët e sotëm të institucioneve jo vetëm që s’janë hapur të reja, por kanë filluar të mbyllen edhe dyert që Kosova i kishte të hapura.





PRESIDENTI I SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS, JOE BIDEN, KA QËNDRUAR TË HËNËN NË KIEV, NË NJË VIZITË TË PAPANALAJMËRUAR

Bideni nga Kievi: Lufta e Putinit po dështon

Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Joe Biden, ka qëndruar të hënën në Kiev, në një vizitë të paparalajmëruar, të parën prej se Rusia nisi pushtimin e këtij vendi gati një vit më parë. Ai është takuar me presidentin ukrainas Volodymyr Zelensky, të cilit i ka rikonfirmuar angazhimin e palëkundur të ShBA-së ndaj demokracisë, sovranitetit dhe tërësisë territoriale të Ukrainës. “Ukraina qëndron në këmbë. Demokracia qëndron. Amerikanët qëndrojnë me ju dhe bota qëndron me ju”, ka thënë Bideni, duke paralajmëruar se ShBA-ja po përgatit një dërgesë të re të “pajisjeve kritike” për Ukrainën, e cila do të përfshijë municione artilerie dhe radarë të mbikëqyrjes ajrore.

Ukrainës”. “Kur [presidenti rus, Vladimir] Putini nisi pushtimin gati një vit më parë, ai mendoi se Ukraina është e dobët dhe se Perëndimi është i përçarë. Ai mendoi se mund të na mposhtë, por e kishte gabim”, është shprehur Biden. Ai shtoi se ShBA-ja po përgatit një dërgesë të re të “pajisjeve kritike” për Ukrainën, e cila, siç tha, do të përfshijë municione artilerie dhe radarë të

mbikëqyrjes ajrore.

Bideni, i cili do ta vazhdojë udhëtimin në Poloni, paralajmëroi edhe sanksione të reja kundër shtetit rus. ShBA-ja është ndër ofruesit më të mëdhenj të ndihmave për ushtrinë ukrainase. Që nga fillimi i pushtimit rus, më 24 shkurt të vitit të kaluar, Uashingtoni i ka dërguar pajisje mbrojtëse dhe logjistike në vlerë prej dhjetëra miliarda

dollarësh.

Presidenti Zelensky ka thënë se vizita e Bidenit është një shenjë jashtëzakonisht e rëndësishme e mbështetjes për të gjithë ukrainasit. “Aktualisht në Ukrainë po vendoset fati i rendit ndërkombëtar”, ka thënë ai. Vizita e presidentit amerikan u zhvillua në kohën kur forcat ruse janë duke sulmuar rëndë pozicionet ushtarake dhe vendbanimet civile në

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

KIEV, 20 SHKURT - Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Joe Biden, ka thënë se Rusia ka bërë përpjekje “ta fshijë Ukrainën nga harta”. Por, sipas tij, “lufta pushtuese” e presidentit rus, Vladimir Putin, “po dështon”. Bideni i bëri komente të hënën gjatë një vizite të paparalajmëruar në Ukrainë, të parën prej se Rusia nisi pushtimin e këtij vendi gati një vit më parë.

Ai u prit nga homologu ukrainas Volodymyr Zelensky, në Pallatin Mariynskiy në qendër të kryeqytetit Kiev. “Një vit më vonë Kievi qëndron në këmbë”, ka thënë Bideni, duke folur nga një podium i dekoruar

me flamurin e ShBA-së dhe të Ukrainës. “Ukraina qëndron në këmbë. Demokracia qëndron. Amerikanët qëndrojnë me ju dhe bota qëndron me ju”, ka thënë ai.

Bideni e ka përgëzuar popullin e Ukrainës për, siç ka thënë, “guximin në luftë” dhe ka shtuar se ShBA-ja do ta vazhdojë mbështetjen për të. “E dija se do të kthehem”, ka pohuar ai, duke kujtuar gjashtë vizitat e tij në Ukrainë gjatë kohës sa ka shërbyer si nënpresident.

Bideni ka theksuar se vizita e tij në Kiev, në prag të njëvjetorit të nisjes së pushtimit rus, konfirmon angazhimin e palëkundur të ShBA-së “ndaj demokracisë, sovranitetit dhe integritetit territorial të



Shqipëria bllokoi anijen me 22 500 tonë naftë kontrabandë nga Rusia

TIRANË, 20 SHKURT - Policia e Shqipërisë ka bllokuar një anije që transportonte 22 500 tonë naftë që vinte nga Rusia. Autoritetet kanë deklaruar se kishte informacione se një anije me flamur liberian do të kontrabandonte në Shqipëri një sasi të madhe nafte dhe organizoi operacionin e koduar "Embargo". "Kjo sasi nafte është marrë nga vendet me embargo për naftën, konkretisht nga Rusia. Anija ishte nisur nga Azerbajxhani dhe pretendohet se më pas është ngarkuar me naftë në portin Kallamata të Greqisë, nga një anije tjetër, në një sasi prej 22 500 tonë naftë", thuhet në njoftimin e policisë shqiptare.

Gjithashtu, bëhet me dije se anija nuk kishte dokumentacion të rregullt, ndaj është bërë sekuestrimi i saj disa milje pranë portit të Durrësit, si dhe janë ndaluar 22 anëtarët e ekuipazhit të cilët do të merren

në pyetje.

Rreth një muaj më parë është zhvilluar një aksion i ngjashëm, ku u sekuestrua një anije libiane, e cila furnizoi në det një anije shqiptare me 50 000 litra naftë kontrabandë.

Aktualisht çmimi i naftës në Shqipëri është 186 lekë për litër. Sipas ekspertëve, Shqipëria ka çmimin më të lartë në rajon për shkak se mbi çmimin e një litri naftë rëndojnë edhe shtatë taksa. Nga ana tjetër, opozita ka akuzuar se çmimi i lartë vjen edhe si pasojë e futjes në Shqipëri të mijëra tonë nafte kontrabandë.

Më 27 shkurt 2022 Shqipëria u është bashkuar sanksioneve që Bashkimi Evropian ka ndërmarrë ndaj Rusisë. Qeveria shqiptare ka vendosur masa kufizuese që do të zbatohen për 654 individë dhe 52 subjekte. Përveç kësaj, është vendosur edhe ndalimi i udhëtimit në territorin shqiptar për personat



e listuar nga BE-ja. Sanksionet ekonomike përfshijnë masa kufizuese në financë, energji, transport dhe teknologji.

Në sektorin e energjisë ndalohet shitja, furnizimi, transferimi ose eksporti në Rusi i mallrave dhe teknologjive

specifike për rafinimin e naftës dhe do të vendosë kufizime në ofrimin e shërbimeve përkatëse.

Dita Botërore e Drejtësisë Sociale, kërkohen taksa progresive dhe paga më të larta për të punësuarit

PRISHTINË, 20 SHKURT - Kryetari i Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës, At dhe Hykollli, ka uruar të punësuarit me rastin e Ditës Botërore të Drejtësisë Sociale. "Sot, më 20 shkurt 2023, e hënë, Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës të gjithë të punësuarve në Republikën e Kosovës po edhe në botë u uron gëzuar Ditën Botërore të Drejtësisë Sociale, dhe njëkohësisht përcjell te të punësuarit në Republikën e Kosovës po edhe te Partneri Social - Qeveria, se është koha për të trajtuar lakminë e korporatave dhe për të taksuar të pasurit për të mirën e shumë njerëzve. Në Ditën Botërore të Drejtësisë Sociale, Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës i



bashkohet Konfederatës Ndërkombëtare të Sindikatave - ITUC e cila i bën thirrje komunitetit ndërkombëtar dhe qeverive kombëtare të trajtojnë lakminë e korporatave,

shmangien e taksave dhe evazionin, rritjen e çmimeve në ushqim dhe karburant, vjedhjen e pagave dhe informalitetin e rrënjësor që i mban dy miliardë njerëz të

papërshtatshëm për mbrojtje sociale", është thënë në urimin e Hykollit.

Ai ka theksuar se bashkë me Konfederatën Ndërkombëtare të Sindikatave - ITUC kërkojnë taksa progresive, paga më të larta dhe të drejta më të forta për marrëveshje kolektive. "Duke përfshirë të drejtën për grevë, si pjesë e një bazamenti për mbrojtjen e punës për të parandaluar rritjen e varfërisë dhe për të promovuar barazinë për të gjithë, e cila parashihet të arrihet, ashtu siç theksohet nga ITUC, me rolin që mund të luajnë Sindikatat e forta; investimet në aftësimin e të punësuarve dhe të atyre që kërkojnë punë; investimet në infrastrukturë; investimet në ekonominë e kujdesit, ku një

shumë modeste mund të krijojë 280 milionë vende pune deri në vitin 2030 dhe të rrisë shkallën e punësimit të grave me 78 për qind; qasja më e gjerë në kujdes, në arsim, në shëndetësi dhe në transport përmes shërbimeve publike cilësore", thuhet në urimin e Hykollit.

Më 26 nëntor 2007 Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara vendosi ta aprovojë 20 shkurtin si Ditën Botërore të Drejtësisë Sociale. Ashtu siç na flet dhe vetë emri, Dita Botërore e Drejtësisë Sociale njeh nevojën për ta promovuar drejtësinë sociale, e cila përfshin përpjekje për të trajtuar çështje të tilla si varfëria, gjithëpërfshirja, barazia gjinore, papunësia, të drejtat e njeriut dhe mbrojtja sociale.

Ukrainën lindore dhe jugore. Rusia kreu dhjetë sulme raketore dhe 25 sulme ajrore në rajonet lindore të Luhanskut dhe Donjeckut, si dhe në rajonin jugor të Zaporizhjes, tha Shtabi i Përgjithshëm i ushtrisë ukrainase në raportin e tij të përditshëm. Sipas tij, sulmet lanë disa civilë të vrarë dhe të plagosur. Pa dhënë më shumë detaje, Shtabi paralajmëroi se kërcënimi nga sulmet ruse mbetet i lartë në të gjithë Ukrainën.

Bideni dhe Zelensky u takuan për herë të fundit në dhjetor, kur presidenti ukrainas qëndroi për vizitë zyrtare në Uashington. Asokohe, Bideni e siguroi homologun e tij se mbështetja e ShBA-së për Ukrainën "do të vazhdojë për aq kohë sa të ketë nevojë".

Diplomatët e BE-së kërkojnë rritjen e prodhimit të municionit për Ukrainën

Diplomatët e lartë të Bashkimit Evropian paralajmëruan të hënë se duhet të gjenden mënyra për të ofruar shpejt mijëra predha artilerie për Ukrainën ose BE-ja do të duhet të përballet me mundësinë e humbjes së luftës kundër Rusisë. Kjo deklaratë erdhi gjatë së hënës kur presidenti i ShBA-së, Joe Biden, bëri një vizitë të papritur në Ukrainë dhe përderisa po raportohet për pakësim të rezervave të municioneve në Evropë. "Sot

çështja më e rëndësishme dhe urgjente për ushtrinë ukrainase është të ketë një fluks të vazhdueshëm municionesh", tha shefi i politikës së jashtme të BE-së, Josep Borrell, përpara se të kryesonte një takim të ministrave të jashtëm të bllokut. "Nëse dështojmë në këtë, me të vërtetë, rezultati i luftës është në rrezik".

Borrelli tha se forcat ruse gjuajnë rreth 50 000 fishekë artilerie çdo ditë dhe se furnizimet e Ukrainës duhet të ngrihen në të njëjtin nivel. Vlerësime të tjera sugjerojnë se Ukraina po gjuan 6 000 deri në 7 000 predha artilerie në ditë, rreth një e treta e totalit të Rusisë.

Borrelli tha se diskutimi brenda BE-së do të përqendrohet në gjetjen e mënyrave për të bërë blerje të përbashkëta

municionesh dhe përdorimin e një fondi të posaçëm të BE-së për të siguruar financim shtesë. Javën e kaluar sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, tha se koha e pritjes për furnizimin e "municioneve të kalibrit të madh është rritur nga 12 në 28 muaj" dhe se "porositë e bëra sot do të dorëzoheshin vetëm dy vjet e gjysmë më vonë".

Estonia, e cila ndan një kufi dhe histori të gjatë me Rusinë, po shtyn BE-në dhe aleatët e saj të NATO-s të ofrojnë 1 milion predha artilerie që, sipas vlerësimeve, do të kushtonin rreth 4 miliardë eurosh. "Rusia përdor çdo ditë [atë që] Bashkimi Evropian e prodhon brenda një muaji dhe, me kapacitetet aktuale të industrisë ushtarake, ne mund t'i

plotësojmë nevojat e Ukrainës pas rreth gjashtë vjetëve, kështu që kjo është plotësisht e papranueshme", u tha gazetarëve Ministri i Jashtëm estonez Urmas Reinsalu. Presidenti ukrainas Volodymyr Zelenskyy u ka bërë thirrje aleatëve të tij përëndimorë që ta shpejtojnë mbështetjen e tyre ushtarake, duke paralajmëruar se vonesat do të jenë në dobi të Rusisë tani që po afrohet përvjetori i parë i nisjes së luftës në Ukrainë më 24 shkurt.

NATO beson se Rusia ka nisur një ofensivë të re në javët e fundit, duke rritur intensitetin e sulmeve në Ukrainën lindore, ndërkohë që edhe po shton forcat në pjesën jugore. Zyrtarët kanë thënë se Ukraina ka të ngjarë ta nisë kundërofensivën e saj në pranverë.

Gruda: Prokuroria t'i intervistojë Kurtin dhe Haxhiun për rastin 'Dehari'

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 20 SHKURT - Koordinator i Departamentit për Drejtësi në Kabinetin për Qeverisje të Mirë të Partisë Demokratike të Kosovës, Përparim Gruda, në një konferencë për medie ka kërkuar të zbardhet rasti i zhdukjes së mostrave të rastit Dehari nga Instituti i Mjekësisë Ligjore.

Gruda i bëri thirrje Prokurorisë së Shtetit t'i intervistojë kryeministrin Albin Kurti dhe ministren e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, pas daljes në publik të fakteve të reja dhe ndërhyrjeve të qeverisë në këtë rast. "Rasti Dehari është një rast tragjik, më të cilin nuk mund të vazhdohet të bëhet politikë, prandaj kërkojmë nga prokuroria e shtetit t'i intervistojë kryeministrin Kurti dhe ministren Haxhiu për të zbardhur përfundimisht se kush dhe si i zhdukuri mostrat e rastit 'Dehari', në mënyrë që të zbardhet e vërteta e plotë e këtij rasti tragjik. Prandaj, kërkojmë drejtësi për rastin 'Dehari'", ka thënë ai.

Sipas Grudës, kryeministri Kurti dhe ministrja Haxhiu duhet ta sqarojnë opinionin publik se pse po heshtin karshi akuzave që i përfshijnë në mënyrë direkte ata në krimin e zhdukjes së mostrave të rastit "Dehari". "Ditët e fundit opinionin publik është njoftuar me fakte të reja në lidhje me zhdukjen



e mostrave të rastit Dehari në Institutin e Mjekësisë Ligjore pranë Ministrisë së Drejtësisë. Pretendimet e ngritura, që përfshijnë në këtë rast kryeministrin Kurti dhe ministren e Drejtësisë Albulena Haxhiu, si pjesëmarrës në zhdukjen e këtyre mostrave në Institutin e Mjekësisë Ligjore. Kryeministri Kurti dhe ministrja Haxhiu duhet të sqarojnë opinionin publik se çfarë dinë ata në lidhje me zhdukjen e mostrave të rastit Dehari, cilat veprime janë

ndërmarrë deri tani për ta zbardhur të vërtetën e plotë, rrethanat e zhdukjes së këtyre provave? Pse po heshtin karshi akuzave që i përfshijnë ata në mënyrë direkte në krimin e zhdukjes së mostrave të rastit Dehari?", shtoi ai.

Po ashtu, PDK-ja shpreh shqetësimin për sulmet e vazhdueshme të ministres Haxhiu mbi organet e pavarura të sistemit të drejtësisë, duke shpërfaqur kështu mendësinë totalitare që po qeverisë Kosovën. "Në seancën

gjyqësore ku ishte e akuzuar për hedhje të gazit lotsjellës, ajo i bëri presion publik prokurorit të çështjes duke i kërkuar që të tërhiqet nga aktakuza kundër saj. 'Dorëzohu, s'është vonë', i tha ajo prokurorit. Kur është vonë që prokurori të tërhiqet? Kur të dënohet ministrja Haxhiu? Kjo është pyetja që duhet të bëjmë në të gjithë. Kjo nuk mund të ndodhë në një vend demokratik. Znj. Haxhiu nuk duhet të harrojë se, përveçqë është e akuzuar në këtë rast, ajo është dhe ministre e

Drejtësisë. Një koment i tillë është qartazi ndërhyrje në drejtësi dhe presion mbi organin e akuzës. Ministrja Haxhiu nuk u ndal me kaq. Pasi si e pandehur i dha urdhër prokurorit të dorëzohet, ajo e sulmoi opozitën duke thënë që ose duhet të bashkëpunojë me ne, ose duhet të heshtë, duke shpërfaqur kështu mendësinë totalitare që po qeverisë Kosovën. Më lejoni të jem i qartë për të gjithë: Ne as nuk do të heshtim as nuk do të dorëzohemi", ka theksuar Gruda.

Mbi 12 milionë euro dëme nga vërshimet në Skenderaj



SKENDERAJ, 20 SHKURT - Një muaj pas vërshimeve në Skenderaj, kryetari i kësaj komune, Fadil Nura, ka njoftuar se i janë drejtuar Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave dhe Komisionit Qendror të Qeverisë për kompensimin e dëmit në vlerën e 12,203,029.29 eurove.

Kryetari Nura ka bërë me dije se 372 familje janë prekur nga përmbytjet e 19 janarit. "Le të jetë kjo javë me lajme të mira nga niveli qendror për ato 372 familje të prekura nga fatkeqësia e përmbytjeve të 19 janarit, që ua shkatërroi pothuajse plotësisht mundin disavjeçar, për bizneset

që humben një pjesë të pasurisë, për bujqësinë dhe të mbjellat që i mori lumi, infrastrukturën publike dhe për çdo dëm tjetër të shkaktuar një muaj më parë! Pas nënshkrimit të kërkesës zyrtare për kompensim të dëmeve, në një vlerësim ku ishin përfshirë njohës të fushave dhe ekspertë, duke vlerësuar kujdesshëm çdo humbje materiale, sot po u drejtohem Agjencionit për Menaxhimin e Emergjencave dhe Komisionit Qendror të Qeverisë për vlerësim të dëmeve për fjalën përfundimtare - kompensimin e dëmit në vlerën e 12,203,029.29 milionë eurove", ka shkruar Nura në "Facebook".

Avokati i familjes Dehari kërkon t'i lejohet pjesëmarrja në intervistimin e Abazit

PRISHTINË, 20 SHKURT - Prokuroria Speciale do ta marrë në pyetje të martën në cilësinë e dëshmitarit deputetin e Lëvizjes Vetëvendosje, Haki Abazin, për rastin e Astrit Deharit. Deputeti Abazi e ka akuzuar javën e kaluar partinë e tij në pushtet,

duke thënë se ekzistojnë videoincizimet ku shihet se kush i ka zhdukur mostrat e aktivistit Astrit Dehari.

Tomë Gashi, avokat i familjes Dehari, ka kërkuar nga Prokuroria Speciale që t'i lejohet pjesëmarrja gjatë intervistimit të deputetit të

Lëvizjes Vetëvendosje, Haki Abazi. "Në cilësinë e përfaqësuesit juridik të familjes Dehari sot me shkrim kam kërkuar që të marr pjesë gjatë marrjes në pyetje të tij (Haki Abazit) në Prokurori", ka shkruar avokati Gashi në "Facebook".



Mërgata vazhdon rekordin e remitencave, gjatë 2022-s solli mbi 1.2 miliard euro në Kosovë



PRISHTINË, 20 SHKURT - Pavarësisht prej krizës botërore të shkaktuar nga agresioni ushtarak rus në Ukrainë, mërgata vazhdon të kontribuojë në dërgimin e parave për familjet në Kosovë. Të dhënat e Bankës Qendrore të Kosovë (BQK) tregojnë se gjatë vitit 2022 diaspora ka dërguar 59.4 milionë euro më shumë. Për këtë periudhë, vlera më e lartë ishte gjatë muajit gusht me 131.6 milionë euro nga totali prej 1.2 miliard eurosh. Sipas kanaleve të dërgimit, BQK-ja thotë se 702.1 milionë euro janë transferuar me anë të agjencive të dërgesave të parave, kurse pjesa tjetër me anë të bankave komerciale dhe

kanaleve alternative.

Ndërsa sa iu përket dërgesave të mërgatës sipas vendeve, Gjermania është shteti ku më së shumti dërgohen para në drejtim të Kosovës. Nga ky vend kanë ardhur 41.2 për qind e dërgesave, ndjekur nga Zvicra me 20.2 për qind dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës me 9.1 për qind. "Remitancat përbëjnë një ndër financuesit kryesor të konsumit dhe kanë një pjesëmarrje prej 14.1-përqindësh në gjithsej Prodhimin e Brendshëm Bruto të gjeneruar në vend. Përveç faktorit altruist që karakterizon dërgesat e emigrantëve në Kosovë, e që mund të jetë

përfuruar si pasojë e tkurrjes së të ardhurave të disponueshme në ekonomi si pasojë e inflacionit, rritja e remitancave gjatë muajve të verës mund t'i atribuohet edhe zhvlerësimit të euros ndaj valutave të tjera", thuhet në raportin e BQK-së për vlerësimin tremujor të ekonomisë, shkruan "Telegrafi". Raporti thekson se në tremujorin e tretë të 2022-s është vënë re një rritje prej 21.6-përqindësh e remitancave të dërguara përmes bankave, ndërsa remitancat përmes agjencive për transferimin e mjeteve shënuan rritje prej 14.3-përqindësh.

Ndërsa sipas Bankës Botërore,

pjesëmarrja e remitencave në PBB-në e Kosovës është rreth 20 për qind, ku nga shpallja e pavarësisë janë dërguar 13 miliardë euro.

Shuma e remitencave të dërguara sipas viteve në Kosovë: 2008 - 858 milionë euro, 2009 - 865 milionë euro, 2010 - 825 milionë euro, 2011 - 814 milionë euro, 2012 - 775 milionë euro, 2013 - 867 milionë euro, 2014 - 901 milionë euro, 2015 - 796 milionë euro, 2016 - 808 milionë euro, 2017 - 911 milionë euro, 2018 - 1.13 miliard euro, 2019 - 1.23 miliard euro, 2020 - 980 milionë euro dhe 2021 - 1.14 miliard euro.

Sa i përket vizitës së mërgatës në

vend, Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës "Adem Jashari" gjatë këtij viti thotë se ka shërbyer numrin më të madh të udhëtarëve ndonjëherë, pra rreth 3 milionë udhëtarë dhe 21 842 fluturime.

Top pesë destinacionet që kanë prirë për nga numri i udhëtarëve që kanë fluturuar drejt Prishtinës përfshijn vendet si Zvicra, Gjermania, Turqia, Austria dhe Britania e Madhe.

Nga rezultatet preliminare të regjistrimit të diasporës, numri i qytetarëve të Kosovës që jetojnë në vende të ndryshme të Evropës dhe botës, të cilët i janë përgjigjur regjistrimit, është rreth 350 mijë.

Bangladeshi po e sheh Kosovën si potencial bashkëpunimi për ta zgjeruar ekonominë digjitale

PRISHTINË, 20 SHKURT - Ministri i Bangladeshit për Teknologjinë, Zunaid Ahmed Palak, ka thënë se ka shumë potencial për partneritet me Kosovën në fushën e tregtisë elektronike. Sipas Palakut, bashkëpunimi me kompanitë për zhvillim softuerik dhe ato outsource në Kosovë mund të jetë një mundësi e shkëlqyer për vendin e tij. "E ardhmja qëndron tek ekonomia digjitale gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme. Të gjithë duhet të jemi në këtë rrugëtim së bashku", tha Palak derisa po fliste në një pritje të organizuar nga ambasadori i Kosovës në Daka, Guner Ureya, me rastin e 15-vjetorit të pavarësisë së Kosovës. Ambasadori Ureya tha se, pavarësisht prej sfidave dhe vështirësive të shumta, qytetarët e Kosovës janë jashtëzakonisht krenarë për



zhvillimin e vendit të tyre. "Republika e Kosovës, shteti më i ri në Evropë, ka avancuar

dukshëm në çdo fushë gjatë 15 vjetëve të fundit. Sot kemi një shtet funksional, të

begatë, stabil dhe multietnik me shoqëri të larmishme dhe ekonomi në rritje të

vazhdueshme", tha Ureya. Ai shpreston se Kosova do të njihet nga të gjitha vendet e Azisë Jugore. "Ne kemi dialog të mirë me disa vende që ende nuk na njohin, por kjo nuk mjafton. Ne meritojmë dhe kemi nevojë për njohje zyrtare. Për shembull, Bangladeshi si dhe Pakistani e Maldivet na njohën dhe tani kemi një marrëdhënie miqësore dhe shumë të ngushtë me ta", tha ai.

Ureya ka shtuar se Kosova dëshiron të vendosë marrëdhënie diplomatike dhe ta zhvillojë bashkëpunimin me Indinë, Nepal, Sri Lankën dhe Butanin.

Të pranishëm në këtë aktivitet ishin diplomatë aktualë dhe ish-zyrtarë të lartë të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe drejtues biznesi.

Misteret e balonave spiune



Nga George FRIEDMAN

Marrëdhënia midis kombeve është gjithnjë komplekse dhe nganjëherë e vështirë për t'u kuptuar. Ndonjëherë ajo hyn në fushën e të çuditshmes. Dhe më pas në nivelin më ekstrem, hyn në botën e balonave, objekteve të pidentifikuara dhe avionëve luftarakë F-22.

Siç thonë në Uashington, që të gjitha këto prodhojnë gënjeshtër dhe konferenca shtypi. Kjo situatë ndërlikohet nga fakti që fajtori i mundshëm, Kina, pretendon se vetë SHBA-ja ka shkelur të paktën 10 herë në territorin kinez me balonat e saj. Kjo është e mundur, por po ashtu ngre pyetjen se përse Pekini lejoi kaq shumë ndërhyrje pa e ngritur aspak zërin.

Sipas Pentagonit, vitet e fundit balonat spiune të Kinës kanë hyrë në hapësirën ajrore të më shumë se 40 vendeve të botës. Duke qenë se këto objekte fluturose janë disi të dukshme nga toka, është e çuditshme që askush nuk i vuri në dukje, ose të paktën ta bënte këtë duke e ngritur zërin publikisht. Pyetja tjetër është se çfarë

kërkonin kinezët, por edhe amerikanët gjithashtu, nëse kundër-akuzat e Pekinit janë të sakta. Të dyja këto vende zotërojnë shumë satelitë spiunazhi, të konceptuar dhe përdorur për të përcaktuar vendndodhjet e avionëve dhe raketave me mbushje bërthamore, të pozicionuar enkas për të zbuluar në kohë reale lëshimin e raketave nga një vend armik.

Këta satelitë evolucionuan në sisteme, të cilat mund të zbulojnë një shumëllojshmëri të gjerë të objekteve në Tokë, si dhe disa që mund të zbulojnë sinjale elektronike. Sigurisht, duket se satelitët janë të dobishëm në misionin e tyre kryesor: Nuk ka pasur asnjë shkëmbim bërthamor.

Por, siç thanë shumë analistët, satelitët nuk mund të zbulojnë gjithçka. Qeveria amerikane nuk ka përshkruar gjithçka që kanë spiunuar balonat e dyshuar kineze, sjellje që është e kuptueshme. Gjithsesi kjo ngjarje më shtyn të pyes veten se çfarë objektesh shtesë kërkonte Kina dhe pse për këtë duheshin sisteme të ngadalta që fluturojnë në lartësi të mëdha.

Natyrisht, balonat nuk kishin për detyrë të zbulonin një sërë objektesh në kohë reale. Për të siguruar një mbulim të gjerë, një numër i madh i këtyre objekteve – ato duhet të quhen objekte dhe jo balona, pasi ato drejtohen të paktën pjesërisht nga Toka – do të duhej të mbulonin qiellin, duke mbetur relativisht të palëvizshme (dhe krejtësisht të pambrojtura), duke transmetuar të dhëna në bazë.

Për këtë arsye ato janë të zbulueshme vizualisht dhe elektronikisht. Ato mund të kenë fotografuar më nga afër objektet në tokë të zbuluara më parë nga satelitët. Objektivat e tyre do të duhej të ishin statike për një kohë të gjatë, pasi balonat lëvizin shumë ngadalë. Shumica e gjërave të tilla vëzhgohen më mirë nga njerëzit në makina ose akoma më mirë, nga shëtitorja me biçikletë apo "ndërrimi i gomës" pranë një baze strategjike. Problemi që kam, është me imagjinimin e misionit që mund të mbikëqyrë këto objekte, një mision që do të ishte i padukshëm, që do të lejonte shëtitorja pranë objektivit dhe që do të ishte në gjendje të shmangte zbulimin.

Mund të ketë disa objektiva shumë të specializuara, por flota që duket se kanë kinezët dhe që ata pretendojnë se e ka edhe SHBA, duket e tepërt për këtë detyrë. Një balonë kineze ishte mbi një bazë të Forcave Ajrore të SHBA-së, që është pa dyshim e ngarkuar me sekrete, por sa prej sekreteve do të ishin të dukshme ose të transmetuara në mënyrë të qartë?

Një mision teorik do të ishte shmangia e vëmendjes. Rusia është shumë më afër Alaskës sesa Kina. Ajo është e përfshirë në një luftë, ku Shtetet e Bashkuara kanë një rol shumë të madh, të cilin nuk mund ta nënvlerësojë. Në këtë kuadër zbulimi i një mjeti të madh dhe të çuditshëm që fluturon mbi Shtetet e Bashkuara mund të shkaktojë panik, dhe publiku kërkon me të drejtë që qeveria të fokusohet në mbrojtjen kombëtare dhe jo tek Ukraina. Ekzistojnë 100 funksione devijuese, për të cilat mund të shërbejnë këto objekte për një kohë të kufizuar, edhe pse ky episod bart shumë panik dhe po kaq konfuzion.

Pyetja kryesore është se si ka mundësi që objekte kaq të mëdha dhe në lartësi, që lejojnë

një shikueshmëri më të madhe, të kalojnë pa u vënë re, gjithnjë nëse janë të vërteta akuzat e SHBA-së dhe Kinës. Nga informacionet e disponueshme, balona lëviz me ritmin e një elefanti dhe mund të qëllohet me avion, raketë apo edhe më një palë "llastiqe".

Ato duhet të jenë shumë të avancuara, gjë që do të shpjegonte arsyen pse qeveria e SHBA-së po i mban fshehur përgjigjet mbi këtë mjet. Nëse fshehtësinë e kërkon siguria kombëtare, atëherë duhet të jetë kështu. Por problemi është se qeveria amerikane po i rrezon këto balona, dhe duke e ditur që në fillim se ato janë kineze, nuk është në gjendje të na thotë se çfarë gjeti në mbetjet e tyre.

Unë nuk besoj se këto pyetje mund të marrin përgjigje duke supozuar se aktorët përkatës janë budallenj ose tradhtarë. Objektet në fjalë kanë nevojë për shpjegim, dhe deri më tani janë të pakuptueshme. Ata që favorizojnë shpjegimet e bazuara tek marrëzia apo tradhtia janë të mirësardhur. Unë preferoj të mendoj se nuk jam në gjendje të kuptoj të vërtetën komplekse. / "Geopolitical Futures" – Bota.al



Veton Zymberi, redaktor i sportit

Liga Kampionëve sjell përballjen Liverpool - Real



“Epoka e re”

LIVERPOOL, 20 SHKURT - Rivalet e vjetër në futbollin evropian, Liverpooli dhe Real Madridi, sonte (e martë) zhvillojnë një tjetër përballje në Ligë e Kampionëve, pas finales 2021-22. Përballja e radhës mes këtyre dy skuadrave është në “Anfield” në kuadër të ndeshjes së parë në 1/16 e finales. Skuadra e drejtuar nga Jurgen Klopp u rendit e dyta në Grupin A pas Napolit, ndërsa Reali ishte i pari në Grupin F. Liverpooli është eliminuar vetëm një herë në këtë fazë, në

edicionin 2019-2020 nga Atletico Madrid. “Reds” e nisi keq vitin 2023, por është rikthyer dhe ka fituar dy ndeshjet e fundit në Premierë Ligë kundër Evertonit dhe Newcastle Unitedit. Në anën tjetër edhe Reali nuk pati një nismë të mirë në Ligën e Kampionëve, por arriti të kualifikohet dhe gjithmonë është i rrezikshëm në këtë garë. Mjafton të kujtohen titujt e fituar dhe ecuria në edicionin e kaluar kur mposhti skuadra si PSG-ja dhe Manchester City. Skuadra e drejtuar nga Carlo Ancelotti pas fitores në fundjavë ndaj Osasunës

arriti triumfin e katërt radhazi. Mungesat e Liverpoolit për këtë ndeshje janë Luis Diaz, Ibrahim Konate, Thiago Alcantara dhe Calvin Ramsay, kurse në dyshim janë Darwin Nunez dhe Arthur. Në anën tjetër, Aurelien Tchouameni, Toni Kroos dhe Ferland Mendy janë mungesat e Realit. Sonte (e martë) zhvillohet edhe një tjetër ndeshje interesante në mes të Eintracht Frankfurtit dhe Napolit.

TË MËRKURËN TAKOHEN:


21:00 Eintracht Frankfurt - Napoli
21:00 Liverpool - Real Madrid

‘Dardanet’ kërkohjnë fitoren e tretë kundër Bullgarisë

ALANYA, 20 SHKURT - Pas dy fitoreve kundër kombëtareve të Estonisë (2-1) dhe Hong Kongut (7-0), “dardanet” kërkohjnë edhe fitoren e tretë kundër Bullgarisë në kuadër të turneut të turneut miqësor “Turkish National Womens Cup Alanya 2023”. Vashat e Kosovës të martën takohen me Kombëtaren e Bullgarisë në orën 11:00 sipas kohës

lokale, përkatësisht në orën 9:00 sipas kohës së Kosovës, në Kompleksin Sportiv “Gold City”. Ato janë shprehur të gatshme për fitore në këtë përballje, derisa përzgjedhësja Anneli Anderson duket se për këtë takim është e përgatitur dhe ka njohuri për cilësinë e Bullgarisë, prandaj në ndeshjen kundër Hong

Kongut i pushuar gati krejt përbërjen e parë në mënyrë që të jenë të gatshme për një tjetër triumf. Në seancën stërvitore para ndeshjes kundër Bullgarisë u provuan shumë skema taktiko-teknike dhe gjithçka që mund të ndodhë gjatë ndeshjes. Atmosfera në mesin e futbollistëve “dardane” është e shkëlqyer.



KB Peja ndahet me Sevimin, angazhon Hadarin

Pejë, 20 shkurt - KB Peja edhe zyrtarisht e ka përfunduar bashkëpunimin me trajnerin Can Sevim. Eliminimi nga Kupa e Kosovës bëri që klubi pejan t'i ndajë rrugët me trajnerin turk. Lajmin e ka konfirmuar skuadra e Pejës, derisa ka paralajmëruar se shumë shpejt do të emërohet

trajneri i ri. “KB Peja njofton se me marrëveshje të dyanshme ka ndërprerë bashkëpunimin me trajnerin Can Sevim. Trajnerin Sevim e falënderojmë për punën e tij të madhe këtë sezon dhe i dëshirojmë shumë suksese në vazhdim”, thuhet në njoftimin e KB Peja.

Pak orë me vonë skuadra nga rrafshi i Dukagjinit e ka paraqitur trajnerin e ri Rami Hadar. “KB Peja ka kënaqësinë të njoftoj se ka nënshkruar me trajnerin e mirënjohur izraelit, Rami Hadar. Trajneri Hadar ka një përvojë të madhe në ligen izraelite dhe Euro League ku

ka udhëhequr ekipet më të mëdha izraelite si Maccabi Tel Aviv, Maccabi Haifa, Hapoel Afula, Hapoel Be'er Sheva etj. Përvoja e tij presim t'i ndihmojë KB Pejës në muajt në vazhdim për ta rikthyer ekipin në luftën për titull”, thuhet në njoftimin e KB Peja.

Ilir Avdyli, ‘Ylli i Javës’ në Superligë

PRISHTINË, 20 JANAR - Federata e Futbollit e Kosovës së bashku me sponsorin e Superligës, Albi Mall, vazhdojnë të japin çmimin “Ylli i Javës” pas çdo xhiroje në Albi Mall Superligë. Çmimi i më të mirit për javën e 20 i ka takuar portierit të FC Llapi, Ilir Avdyli. Komisioni vlerësoi se portieri i llapjanëve ishte më i merituari në fitoren që skuadra e tij e arriti kundër Trepçës '89 (2:1). Ai përgjatë tërë ndeshjes pati performancë të jashtëzakonshme, ku fillimisht priti penalltinë te rezultati 0:0, derisa më pas pati

edhe disa intervenime të tjera gjatë lojës, duke mos lejuar skuadrën kundërshtarë t'ia rrezikojë fitoren KF Llapi. Shpallja e tij si më i miri i javës së 20 është një nder i veçantë për portierin e llapjanëve dhe dëshmon kualitetin dhe aftësitë e tij të jashtëzakonshme në portë. Pa dyshim ky çmim do të mund të shërbejë edhe si frymëzim për bashkëlojtarët e tij për paraqitje edhe më të mira në ndeshjet e ardhshme. “Të shpallësh më i miri i xhiros është një kënaqësi e madhe

sidomos për faktin që kjo xhiro ka pasur shumë gola dhe rrjedhimisht konkurrenca për ‘Yllin e Javës’ ka qenë e madhe. Ndeshjet si vendas dhe presioni i pikëve nuk lejojnë që ekipi të jetë i liruar dhe të bëjë lojë kreative, prandaj edhe ndeshja me Trepça '89 ka qenë e vështirë. Më gëzon fakti që e kam ndihmuar ekipin t'i arkëtojë tri pikë shumë të rëndësishme për vazhdimësi më të qetë në Albi Mall Superligë. Falënderoj bashkëlojtarët për mundin dhe angazhimin që e bëjnë



çdo ndeshje. Llapi synon që të renditet i treti në tabelë dhe si zakonisht ta fitojë Kupën e Kosovës. Besoj se jemi në rrugë të duhur për t'i arritur

objektivat tona dhe do të punojmë shumë nga ndeshja në ndeshje”, ka thënë Avdyli për faqen zyrtare të FFK-së pas marrjes së këtij çmimi.

Greza rikthehet te Zalaegerszeg

ZALAEGRSZEG, 20 SHKURT - Eros Greza do ta vijojë karrierën në Hungari, ku do të luajë me skuadrën e Zalaegerszegut, ekipi me të cilin është aktivizuar për gjysmë sezoni në edicionin 2021-2022. Sulumuesi i Kombëtares së

Shqipërisë transferohet si një lojtar i lirë për shkak se ka ndërprerë kontratën pak javë më parë me skuadrën turke të Manisa, ku luajti në tetë ndeshje, por vetëm një si titullar. Në përvojën eksperiencën e tij të parë te

Zalaegerszeg, Greza luajti vetëm në pesë ndeshje, duke shënuar një gol. 27-vjeçari ka nënshkruar për një vit e gjysmë, ndërsa drejtori sportiv i klubit Attila Dragoner u shpreh i lumtur për afrimin e lojtarit të

kombëtares së Shqipërisë, për të cilin tha se beson shumë se Greza do ta ndihmojë ekipin me përvojën e tij, ndërsa veçoi se shpreson që në këtë aventurë të dytë të lojtarit, ai të ambientohet sa më parë për ta dhënë kontributin e tij.



Spektakël në All Star Game, fiton ekipi i Giannis, Tatum shpallet MVP

NJU-JORK, 20 SHKURT - Skuadra e drejtuar nga Giannis Antetokounmpo (Team Giannis) fitoi ndeshjen magjike të All Star Game në NBA, duke mundur në finalen e yjeve 184-175 skuadrën e LeBron Jamesit. Dy kapitenët e skuadrave luajtën shumë pak në këtë ndeshje për shkak të problemeve fizike: Giannis vetëm 20 sekonda si titullar, ndërsa LeBron 14 minuta dhe nuk u aktivizua fare në pjesën e dytë. Trofeun MVP të këtij takimi e mori basketbollisti Jayson Tatum i ekipit fitues të "Team Giannis", që realizoi 55 pikë e 10 rebounde, një rekord për All Star Game. Ai ishte shënuesi më i mirë i ndeshjes, mbështetur edhe nga Donovan Mitchell me 40 pikë. Kjo është hera e parë në



karrierë që Tatum fiton këtë çmim prestigjioz, ashtu sikurse është hera e parë që Giannis Antetokounmpo fiton këtë finale si kapiten. Për skuadrën e "Team LeBron", shënuesit më të

mirë ishin Irving dhe Embiid me nga 32 pikë secili. Kështu, pas pes fitoresh radhazi si kapiten, LeBron Jamesi pëson humbjen e parë në All Star Game.

Joshua, rivalëve: S'kam më asgjë për të humbur

LONDËR, 20 SHKURT - Pavarësisht dy humbjeve ndaj Oleksandr Usyk, ku humbi titujt kampionë bote në peshën e rëndë, boksieri britanik Anthony Joshua mendon se mund të rikthehet në majën e botës. 33-vjeçari, në prag të duelit që do të zhvillojë ndaj amerikanit Jermaine Franklin (më 1 prill në Londër), shpreh optimizëm për të ardhmen e tij. Për këtë sfidë ai do të ketë në krah një trajner të ri, Derrick James, me të cilin po stërvitet në Hjuston. "Kur jeni duke kërkuar për madhështinë, kur jeni duke kërkuar për më mirë, duhet të dilni jashtë zonës suaj të rehatisë dhe të nisni të kërkoni. Përfundova në Teksas dhe Derrick James është një trajner i mirë mes shumë trajnerëve të tjerë atje. Ndjeva se Derrick ishte një përshtatje e mirë për mua", ka thënë Joshua për "Sky Sports News". "Kryesore për mua është se do të përballem me Franklin me një mentalitet të ri. Për këtë luftë, për herë të parë pas shumë kohësh, ndjej se nuk kam asgjë për të humbur. E shoh veten si



një pretendent. Kur ke titujt dhe je kampion, duhet të luftosh në një mënyrë të caktuar. Sepse je kundër dikujt që vjen të marrë atë që ke", ka deklaruar Joshua. "Tani unë nuk kam asgjë për të mbrojtur, kështu që do të hyj me një mentalitet të ndryshëm, kështu që kjo është ajo që

ndryshon. Është një tranzicion i natyrshëm. Ashtu si gjahtari dhe i gjuajturi. Unë jam thjesht në skajin tjetër të spektrit tani dhe më duhet të rindërtoj. Jermaine Franklin është gjithashtu në të njëjtin fund të spektrit, kështu që do të jetë një luftë e mirë", u shpreh Joshua.

SHKURT

Marcelo ndahet me Olympiacosin, mund t'i bashkohet Ronaldos

Marcelo ka shumë gjasa ta vazhdojë karrierën në Arabinë Saudite. Të paktën këtë gjë raportojnë mediet në Itali të cilat thonë se mbrojtësi 34-vjeçar ka një ofertë nga Al Nassr për ta vazhduar karrierën pranë Cristiano Ronaldos. Marcelo është larguar nga Olympiacos në më pak se një vit që nga nënshkrimi. Sipas medieve spanjolle, klubi dhe mbrojtësi ranë dakord për ta zgjidhur kontratën pas vetëm 10 paraqitjeve me ekipin grek. Marcelo luajti 10 ndeshje në total, 5 në ligë, 2 në Ligën e Evropës dhe 3 në Kupën e Greqisë, duke shënuar në total vetëm 3 gola. Destinacioni i mundshëm mund të jetë pranë ish-mikun të tij më të mirë te Real Madrid, Cristiano Ronaldo, por ende nuk ka ardhur ndonjë ofertë zyrtare për të nga klubi saudit.

Wolff: E zgjidhëm problemin kryesor, tani radha për pistë

Më në fund te Mercedesi kanë zgjidhur problemin e mbipeshës dhe njëvendëshja që do të paraqitet këtë sezon në pistë është në limitin e kërkuar nga Formula 1: 798 kg. "Jemi në limitin e peshës, gjë që vitin e kaluar në ka panelizuar shumë. Ishte thelbësore që ta përmirësonim makinën në këtë drejtim dhe ia dolëm mbanë", ka thënë Toto Wolff, shef i Mercedesit. "E pranoj që vjet ishim mbipeshë përgjatë gjithë sezonit. Edhe në garën e fundit. Ndaj u përqendruam në këtë detaj për të gjetur një zgjidhje, për të mos qenë në të njëjtën pozitivë si vjet. Mendoj se ia dolëm mbanë, pasi vjet iu afruam shumë, por pa sukses", ka shtuar Wolff. "Kjo është një temë e mbyllur, pasi u morëm seriozisht me atë. Fakti që makina është e zezë nuk ndikon shumë në mbipeshë. Për mua është pozitiv fakti që vendosëm të rikthehem në njëvendëshja e zezë. Tani presim që kjo makinë të jetë e shpejtë në pistë", ka deklaruar Toto Wolff.

Xavi: Tash mendojmë për ndeshjen ndaj Unitedit

Trajneri i Barcelonës, Xavi Hernandez, nuk e ka fshehur kënaqësinë për suksesin e pastër kundër Cadizit që e ka kthyer ekipin e tij përsëri tetë pikë nga Reali ndjekës. Xavi ka thënë se sukcesi ishte i merituar, me Barçën që nuk e diskutoi për asnjë moment fitoren. "Mendoj se ishte një fitore e merituar, e kemi dominuar tërësisht takimin. Dy golat e shënuar në fundin e pjesës së parë na kanë ndihmuar. Më pas në pjesën e dytë jemi munduar të administrojmë rezultatin. Cadizi është mbrojtur me shumë forca dhe ka qenë e vështirë. Megjithatë, kemi treguar se jemi në gjendje të çajmë edhe mbrojtje të tilla. Kemi kthyer përsëri diferencën me Realin e Madridit dhe tani duhet të nisim të mendojmë për Ligën e Evropës", ka thënë Xavi.

Trajneri i Unitedit: Ne nuk mendojmë për titull

Manchester Unitedi ka fituar më shumë ndeshje se çdo skuadër tjetër në pesë kampionatet kryesore të Evropës këtë sezon (27) dhe që tani totali i tyre është 7 ndeshje më shumë sesa arritën gjatë

gjithë sezonit të shkuar (20). Erik ten Hag e quan një katastrofë pjesën e parë ndaj Leicester Cityt, ndërsa për rihapjen e garës për titull tregohet i kujdesshëm: "Jemi të kënaqur me rezultatin, është i

shkëlqyer. Kur luan çdo tri ditë nuk mund të presësh të bësh të njëjtën ndeshje. Ishte e vështirë. Në pjesën e parë Leicesteri luajti shkëlqyeshëm, ne ishim katastrofë dhe të padisiplinuar. Nuk pësuam gol

vetëm prej De Geas. Rashfordi po shkel në pozicionet e duhura, por mos harroni skuadrën. Bruno dha dy asistime të shkëlqyera. Ne nuk mendojmë për garën për titull. Ne mendojmë vetëm për

ndeshjen e radhës. Të enjten kemi një sfidë të madhe përpara. Duhet të luftojmë. Tifozyt duhet ta bëjnë 'Old Trafford' një fortesë dhe plani për ndeshjen me Barçën duhet të jetë i duhuri".

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Quintech" SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811308809 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Quintech" D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811308809 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability "Quintech" L.L.C. has come to the decision to quit its business: 811308809 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Trepça Shoqëri Aksionare
Trepça Deonitarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company

**CALL FOR OFFERS**

We would like to invite all interested bidders to participate in our call for offers for the sale of Lead and Zinc concentrate, as per Reference number T-001/2023 and the quantities for each lot are as follows:

Lot 1:

- Approximately 6,657.51 wmt of Stanterg Lead concentrate
- Approximately 1,250.00 wmt of Artana Lead concentrate

Lot 2:

- Approximately 9,192.38 wmt of Stanterg Zinc concentrate
- Approximately 2,000.00 wmt of Artana Zinc concentrate

The location of the sale is Trepça JSC in Mitrovica, Republic of Kosovo.

A site visit for interested bidders will take place on March 3, 2023, from 10:00 AM to 02:00 PM. The deadline for bid submission is March 17, 2023, at 1:00 PM, with the tender opening at 01:30 PM on the same day.

For more information, please contact the procurement team at trepcaprokurimi@yahoo.com or the sales department. You can also visit the following link: <https://e-prokurimi.rks-gov.net> or Trepça's website at www.trepcacorporation.com.

Thank you for your interest, and we look forward to receiving your offers.

**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

- Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.



Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë Sh.A.
Kosova Landfill Management Company J.S.C
Rr. Bekim Fehmiu 137, Lakrishtë, 10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 (0) 38 600 551; 600 552
www.kmdk-ks.org

KOMPANIA PËR MENAXHIMIN E DEPONIVE NË KOSOVË SH.A

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Ligjin Nr. 03/L-212 i Punës konkretisht Neni 8, bazuar në Rregulloren Nr. 23/2020 për Procedurat e Punësimit, Strukturën Organizative, Kategorizimin dhe Përshkrimin e vendeve të punës në KMDK SH.A, bazuar në Udhëzimin Administrativ (MPMS) Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik dhe bazuar në Vendimin e Kryeshefit Ekzekutiv të KMDK SH.A me Nr.15/2023 me nr. të protokollit 02-07/15 KMDK SH.A shpall këtë:

KONKURS PUBLIK (PËR PLOTËSIMIN E VENDIT TË PUNËS)

Titulli:– Asistent Administrativ i Kryeshefit Ekzekutiv I (Një) Pozitë

Numri i Referencës: ZP/KJ-4-2023

I raporton: Kryeshefit Ekzekutiv

Niveli i pagës: VIII

Orët e Punës: 40 orë në javë

Kohëzgjatja e kontratës: Me kohë të caktuar (1 vit) me mundësi vazhdimi

Vendi i punës: KMDK-së SH.A

Detvrat dhe përgjegjësitë:

- Është përgjegjës për pranimin e palëve të KE, përkatësisht caktimin e termineve të takimeve të KE me palët;
- Pranon postën dhe pas kontrollimit nga KE, bën shpërndarjen e të njëjtës;
- Mban evidencën dhe përkujtuesin e punëve dhe takimeve të KE;
- Pranon thirrje telefonike;
- Kujdeset për furnizim me kohë të materialit shpenzues për KE;
- Kujdeset për përgatitjen me kohë të materialeve të KE, si hartimi, shumëzimi, arkivimi, shpërndarja etj;
- Kujdeset për rregullimin teknik të zyrës së KE;
- Është përgjegjës për pranimin e e-maileve zyrtar të ndërmarrjes;
- Kryen edhe punë tjera sipas kërkesës së KE, të cilat për nga natyra i përkasin këtyre detyrave të punës;

- Për punën e tij/saj i përgjigjet KE;
- Kryen detyra të tjera shtesë sipas ligjeve në fuqi që ndërlihen me pozitën e caktuar.

Kualifikimet:

- Diploma e shkollës së mesme.

Aftësitë krvesore

- Ai/Ajo duhet të ketë shkathhtësi të dëshmuara në administratë dhe njohuri të procedurave të punës në zyre duke përfshirë aftësitë në të folur dhe të shkruar.

Procedura e konkurrimit

Kandidatët e interesuar, formularin zyrtar mund ta marrin në zyrat e Burimeve Njerëzore të KMDK SH.A apo ta shkarkojnë nga web faqja e internetit në adresën: <https://kmdk-ks.org/>. Dokumentacionin mund ta paraqesin në kopje fizike në zyrat e Burimeve Njerëzore në adresën: Rruga "Bekim Fehmiu" Nr. 137, 10000 Prishtinë, Kosovë (Afër Shkollës Shtjefën Gjeçovi), Lakrishtë. Tel: 038/ 600 – 552.

Kandidatët të cilët konkurojnë duhet të shënojnë saktë adresën, numrin e telefonit kontaktues si dhe email adresën. Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen në procedura të tjera të rekrutimit.

Dokumentacioni i nevojshëm:

- Aplikacioni,
- CV,
- Diploma,
- Certifikatat mbi kualifikimet dhe trajnimet,
- Dëshmi mbi përvojën në punë, si dhe dëshmi të tjera në bazë të kualifikimit dhe aftësive.
- Certifikatë nga Gjykata kompetente që nuk është duke u zhvilluar procedurë penale dhe që nuk është i/e dënuar për kryerjen e ndonjë vepre penale (jo më e vjetër se 6 (gjashtë) muaj nga data e lëshimit).

Shënim: Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda tri (3) ditësh. Aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe ato të pa kompletuara me dokumentacionin përkatës nuk do të shqyrtohen.

Afati për aplikim është 15 ditë nga dita e publikimit të Konkursit të Jashtëm në Gazetat/Platformat Elektronike dhe Web-Faqe të KMDK-së, duke filluar nga data: 21.02.2023 deri me datën 07.03.2023 ora 08:00-16:00.

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në Zyrën e Burimeve Njerëzore të KMDK SH.A

Email: info@kmdk-ks.org

Tel: 038/ 600 – 552.



Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë Sh.A.
Kosova Landfill Management Company J.S.C
Rr. Bekim Fehmiu 137, Lakrishtë, 10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 (0) 38 600 551; 600 552
www.kmdk-ks.org

KOMPANIJA ZA UPRAVLJANJE SKLADIŠTIMA NA KOSOVU

Na osnovu Zakona br. 03/L-087 za javna preduzeća, Zakon br. 03/L-212 o radu, konkretno član 8, na osnovu Uredbe br. 23/2020 o postupku zapošljavanja, organizacionoj strukturi, kategorizaciji i opisu poslova u KMDK S.A., na osnovu Administrativnog uputstva (MPMS) br. Službenik KMDK S.A. sa brojem 15/2023 sa protokolom broj 02-07/15 KMDK S.A. saopštava:

JAVNI KONKURS (ZA POPUNJAVANJE RADNOG MJESTA)

Zvanje: Administrativni pomoćnik glavnog izvršnog službenika 1(jedna)pozicija

Referentni broj: ZP/KJ-4-2023

Izveštava: Glavni izvršni direktor

Visina plate: VIII

Radno vrijeme: 40 sati sedmično

Trajanje ugovora: Na određeno (1 godina) sa mogućnošću produženja

Radno mjesto: KMDK dd

Dužnosti i odgovornosti:

- Odgovoran je za prihvatanje stranaka EK, odnosno određivanje datuma sastanaka EK sa strankama;
- Prima poštu i nakon provjere od strane EK-a istu distribuira;
- Čuva evidenciju i podsjetnike o poslovima i sastancima EK;
- Prihvata telefonske pozive;
- Stara se o blagovremenom snabdevanju potrošnim materijalom za KE;
- Vodi računa o blagovremenoj pripremi EK materijala, kao što je izrada, umnožavanje, arhiviranje, distribucija itd.;
- Brine o tehničkoj regulativi Kancelarije EK;
- Odgovoran je za prijem službenih e-mailova kompanije;
- Obavlja i druge poslove na zahtjev EK koji po prirodi spadaju u ove radne obaveze;
- EK je odgovorna za njegov/njen rad.
- Obavlja i druge dodatne poslove u skladu sa važećim zakonima koji se odnose na raspoređeno radno mjesto.

Kvalifikacije:

- Diploma srednje škole

Ključne vještine

- On/ona mora imati dokazane administrativne vještine i poznavanje procedura kancelarijskog rada uključujući govorne i pismene vještine;

Konkursna procedura

Zainteresovani kandidati mogu dobiti zvanični formular u kancelariji za ljudske resurse KMDK SH.A ili ga preuzeti sa web stranice na adresi: <https://kmdk-ks.org/>. Dokumentacija se može dostaviti u fizičkoj kopiji kancelariji za ljudske resurse na adresi: ulica „Bekim Fehmiu“ br. 137, 10000 Priština, Kosovo (blizu škole Shtjefën Gjeçovi), Lakrishtë. Telefon: 038/ 600 – 552.

Kandidati koji se takmiče moraju ispravno unijeti adresu, kontakt telefon i email adresu. Samo odabrani kandidati će biti pozvani na dalje procedure zapošljavanja.

Potrebna dokumentacija:

- Aplikacija
- Životopis,
- Diploma,
- Sertifikate o kvalifikacijama i obuci,
- Dokaz o radnom iskustvu, kao i drugi dokazi na osnovu kvalifikacija i vještina.
- Uvjerenje nadležnog suda da se ne vodi krivični postupak i da nije osuđivan za neko krivično djelo (ne starije od 6 (šest) mjeseci od dana izdavanja)

Napomena:

Prijave poslate poštom, koje su obilježene poštanskim žigom posljednjeg dana roka za prijavu, smatrat će se valjanim i bit će uzete u obzir ako stignu u roku od tri (3) dana. Prijave koje pristignu nakon ovog roka i one koje nisu kompletirane sa odgovarajućom dokumentacijom neće se razmatrati.

Rok za prijavu je 15 dana od dana objavljivanja Eksternog konkursa u novinama/elektronskim platformama i sajtovima KMDK, počev od: 21.02.2023. do 07.03.2023. godine, 08:00-16:00 časova.

Za detaljnije informacije možete se obratiti Službi za ljudske resurse KMDK SH.A

Email: info@kmdk-ks.org

Telefon: 038/ 600 – 552.

ROYAL CROWN
RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



PASHTETË PULE

MEKA
HALAL FOOD

gluten
free



100% mish pule



cilësi e garantuar

pa konservues